

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit shpall një vend pune për personel akademik me kohë të plotë të kategorisë “Lektor”, në Grupin Mësimor të Materialeve për mbulimin e lëndëve si më poshtë:

1. Lënda: “Materialet Qeramike të Avancuara”, 6 ECTS leksione, seminare dhe laboratorë. Lënda zhvillohet në semestrin e I të vitit II, në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Materiale.
2. Lënda: “Korrozion dhe Degradim i Materialeve”, 3 ECTS leksione dhe seminare. Lënda zhvillohet në semestrin e II të vitit II, në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale.
3. Lënda: “Kimi Fizike”, 3 ECTS leksione dhe seminare që zhvillohet në semestrin e I të vitit II, në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale.
4. Lënda: “Materialet Qeramike Tradicionale”, 6 ECTS, që zhvillohet në semestrin e II të vitit III, në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale.

II. Kriteret e punësimit për vendin vakant për personel akademik me kohë të plotë janë si më poshtë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e ciklit të parë dhe të dytë në Inxhinieri Materiale dhe/ose Kimi.
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e ciklit të tretë, “Doktor i Shkencave”.
3. Të ketë mesataren e ponderuar për të dyja ciklet mbi 80%.
4. Të ketë njohuri në fushën e nanomaterialeve.
5. Të ketë njohuri në fushën e akreditimit të laboratorëve kërkimorë shkencorë dhe aftësi për zbatimin e standardit ISO 17025.
6. Kandidati duhet të ketë eksperiencë së paku 5 (pesë) vite në mësimdhënie.
7. Kandidati duhet të ketë përvojë të dokumentuar kërkimore në fushën e korrozionit.
8. Kandidati duhet të zotërojë një gjuhë të huaj, me dëshmi apo certifikatë (preferohet anglishtja).

III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
5. Fotokopje e gradës shkencore “Doktor”;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **10.04.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.